



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 148, datë 30.09.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E SHOQËRISË “GRANT THORNTON” SH.P.K., SI SHOQËRI  
AUDITUESE PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË SË  
SIGURIMIT “INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP” SH.A., PËR VITIN  
FINANCIAR QË MBYLLET NË DATË 31.12.2025**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 123, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 37, datë 28.05.2015, “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e shoqërisë “Grant Thornton” sh.p.k., si shoqëri audituese për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit “Intersig Vienna Insurance Group” sh.a., për vitin financiar që mbyllet në datë 31.12.2025.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI**